

NDËRTO NJË KARRIERË, BËHU PROFESIONIST!

DIPLOMË PROFESIONALE E ARSIMIT TË LARTË NË
ESTETIKË · HAIR ARTIST · MAKE UP ARTIST
MENAXHIM I SPA-VE & BIZNESIT TË BUKURISË

GUIDA STUDENTORE 2024-2025

ÇFARË ËSHTË TESS?

TESS është fryshtuar nga dëshira për ta bërë estetikën dhe të bukurën pjesë të jetës së përditshme, kudo. TESS është **Kolegji Profesional i Lartë** i parë, i vërtetë, i cili krijon profesionistë me njohuri të plota në programet e estetikës, parukerisë dhe make up.

Me bashkëpunimin e kompanive të njohura në botë MAKE UP FOR EVER, Davines dhe Comfort Zone dhe me staf të specializuar në make up, estetikë, parukeri, dermatologji, psikologji, ligj, menaxhim, marketing, art, fotografi dhe sociologji, TESS i aftëson studentët me njohuritë e duhura për t'u bërë profesionistë të suksesshëm.

Kolegji Profesional i Lartë TESS është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 483, datë 31.07.2018 dhe është i organizuar në dy departamente:

- a) Departamenti i Estetikë-Nutricionit
- b) Departamenti i Kozmetologjisë

CILAT PROGRAME STUDIMI OFRON TESS?

Programet e Kolegjit Profesional të Lartë TESS janë të licensuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe të akredituara nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) si programe studimi profesionale me kohëzgjatje 1 ose 2 vite akademike, pas arsimit të mesëm, në përfundim të të cilave do të merrni një Diplomë Profesionale me 60 ose 120 Kredite ECTS.

PROGRAMI I STUDIMIT ESTETIKË

Profilii Estetikë është një program 2-vjeçar. Programi i studimit për estetistët synon të krijojë profesionistë në fushën e estetikës. Roli kryesor i estetistes është të kujdeset për lëkurën dhe kjo mund të arrihet duke pasur një profil të plotësuar në 360 gradë për sa i përket të gjitha njohurive teorike, informacionit që merret nga studimet shkencore, e gjithashtu demonstrimeve dhe praktikave në të gjitha disiplinat e fushës.

KOHËZGJATJA: 2 VITE AKADEMIKE
(1500 ORË MËSIMORE TË NDARA NË 4 SEMESTRA)



PROGRAMI I STUDIMIT HAIR ARTIST

Profilii Hair Artist në TESS zhvillohet gjatë një programi 2 vjeçar. Ky program ka si synim përgatitjen e profesionistëve në këtë fushë duke ofruar një formim të plotë. Programi përfshin njohuri që lidhen me anatominë, flokët e trikologjinë e gjithashtu njohuri që lidhen me aftësitë menaxheriale dhe komunikuese të domosdoshme për këtë fushë. Një domosdoshmëri për këtë fushë janë edhe njohuritë teorike, demonstrimet dhe praktikat lidhur me proceset e flokëve, si trajtimet, lyerja dhe prerja të cilat do të studiohen në profilin Hair Artist.

KOHËZGJATJA: 2 VITE AKADEMIKE
(1500 ORË MËSIMORE TË NDARA NË 4 SEMESTRA)

PROGRAMI I STUDIMIT MAKE UP ARTIST

Ky program studimi është krijuar për të mundësuar një formim të plotë e gjithë përfshirës për të fituar njohuritë e nevojshme për profesionin e make-up artist. Kjo mund të arrihet duke maksimizuar aftësitë krijuese të studen tëve e duke përforcuar talentin që ata kanë, për të qenë të përgatitur të plotësojnë të gjitha kërkesat si profesionistë të fushës në nivelet e kërkua të sotme.

Programet përfshijnë leksione mbi rëndësinë e studimeve teorike, të kombinuara me demonstrime, praktika një-më-një dhe projekte individuale.

KOHËZGJATJA: 1 VITE AKADEMIKE
(750 ORË MËSIMORE TË NDARA NË 2 SEMESTRA)



CILA ËSHTË KARRIERA E ARDHSHME E NJË PROFESIONISTI PASI KA STUDIUAR NË TESS?

PUNA E NJË ESTETISTI

Për ata që pëlqejnë fushën e kozmetologjisë, por duan të specializohen në studimin e kujdesit ndaj lëkurës karriera si estetist është e duhura. Pasi diplomohen, studentët punojnë në SPA apo sallone duke i ofruar klientëve trajtime dhe terapi për fytyrën dhe trupin, refleksologji të këmbëve, aromaterapi dhe trajtime me dyllë. Shkolla për estetistë mëson gjithashtu njohjen e problemeve të lëkurës të cilat kanë nevojë për formim në fushën e dermatologjisë.

Një estetist/e i/e mirë duhet të jetë i/e aftë të punojë mirë me duar dhe të ketë sjellje të këndshme. Ato/ata duhet të ndjehen komod të punojnë me klientë një-më-një dhe njëkohësisht duhet ta bëjnë klientin të ndjehet i qetësuar dhe i informuar mbi nevojat e kujdesit ndaj lëkurës. Nevoja për profesionistë në fushën e estetikës është me trend në rritje edhe në vendet e zhvilluara të botës. Punët që mund të kryejë një person me formim si estetist lidhen me shërbimet në sallone dhe SPA si estetistë, instruktorë në shkolla për trajnime estetike, zhvillues të linjave të produkteve estetike apo përfaqësues shitje në kompani të cilat tregtojnë produkte të kujdesit ndaj lëkurës.

PUNA E NJË ESTETISTI

Stilisti i flokëve është profesionisti i pamjes së jashtme i cili pret dhe stilon flokët. Sipas Byrosë së Statistikave të Punës së Sh.B.A, stilistët e flokëve referohen shpesh si kozmetologë, edhe pse kozmetologët janë edhe trajtime të tjera si kujdesi për duart apo kujdesi për këmbët. Stilistët e flokëve përdorin një varietet teknikash stilimi për të ndryshuar apo mirëmbajtur stilin e flokëve të klientëve.

Stilistët e flokëve e fillojnë punën me një konsultim për të përcaktuar nevojat e klientit përpara se të përcaktojnë se cilën metodë do aplikojnë. Pas stilimit ata janë këshilla për mirëmbajtjen e flokëve në shtëpi.

Këta individë kanë nevojë që të trajnohen për mënyrën se si duhet ta marketojnë veten dhe të krijojnë dhe mbajnë bazën konsumatore. Stilistët e flokëve të cilët hapin sallonet e tyre kanë edhe detyra të tjera të cilat përfshijnë mbajtjen e llogarive, porositë, supervizimin e personelit.

Byroja e Statistikave të Punës së Sh.B.A, tregon se mundësitet e punëve për stilistët e flokëve dhe kozmetologëve parashikohet të rritet 8 % në 2022-2032. Stilistët e flokëve mund të punojnë si berber, në sallone, në hotele, SPA ose resorte. Nevojat në rritje për stilistë flokësh do të çojnë në rritje të mundësive të punësimit. Stilistët e flokëve mund të punësohen edhe në industritë e lidhura me imazhin si për shembull në modelim dhe televizion.

PUNA E NJË MAKE UP ARTIST

Një make up artist është një person i cili përdor teknika kozmetike për të krijuar bukuri tek trupi njerëzor. Artisti e di se si ta bëjë subjektin e artit të tij të duket në formën e tij më të mirë dhe njëkohësisht di si ta përshtatë artin në përpunësje me kushtet e drithës dhe fotografisë dixhitale. Falë aparateve fotografike dixhitale, artistët e make up kërkojnë gjithnjë e më shumë në dasma, fotografime mode, evenete mode, fotografim për personelin e kompanive dhe në ngjarje të tjera të cilat fotografohen apo filmohen.

Tipi tjetër kryesor i punës si Make Up Artist (Artist Grimi), është Make Up Artist për teatrin dhe filmin. Në këtë rast artisti bën më të dukshme tiparet e aktorit për të theksuar karakterin që ai ose ajo luan në artin që performon. Aktorët e rinj mund të grimohen që të duken të vjetër, aktorët e vjetër që të duken më të rinj, karaktere kreative mund të krijohen nga asgjëja dhe make up mund të ndryshojë ndërsa karakteri ndryshon përgjatë historisë. Sikurse një make up artist që punon në fushën e modës, edhe një make up artist në teatër dhe film mës on se si duhet punuar në kushte të ndryshme të ndricimit, distancën mes skenës dhe audiencës, dhe kushtet që përcaktohen nga kamerat dixhitale dhe high-definition. Në shkallën e tyre më kreative, artistët e efekteve speciale krijojnë personazhë plot fantazi, iluzione gjakosje dhe plagësh, krijesa të kohëve të vjetra etj. Kjo fushë është një nga më kreativet për make up-in dhe njëkohësisht një nga më sfidueset.

Cilësitet e një artisti të mirë përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm tek: shërbim i shkëlqyer ndaj klientit, kreativitet, vetë-motivim, menaxhim i mirë i kohës, të kuptuarit të artit dhe dizajnit, dëgjues i mirë, komod në bërjen e rekomandimeve dhe dhënien e feedback-ut ndaj klientëve, aftësi për të parë detajet.

CILA ËSHTË KARRIERA E ARDHSHME E NJË PROFESIONISTI PASI KA STUDIUAR NË TESS?

Në përfundim të programeve Estetikë, Hair Artist dhe Make Up Artist, studentët tanë do të pajisen me një DIPLOMË PROFESIONALE të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Këto diploma janë me 60 ose 120 Kredite ECTS. Profili Make Up është një program 1 vjeçar dhe diploma do të lëshohet në përfundim të përvetësimit të tij gjithë lëndëve të kurrikulës, ndërsa diplomimi në profilin Estetikë dhe Hair Artist do të kryhet në përfundim të kurrikulës 2 vjeçare.

CILËT JANË PARTNERËT KRYESORË TË TESS?



MAKE UP FOR EVER
PROFESSIONAL – PARIS

[comfort zone]

SKIN SCIENCE SOUL



"Davines" jo vetëm që dëshiron të bëhet kompania kozmetike më e bukur në botë, por edhe më etike. Fjala "etike" lidhet me artin e ndërtimit të marrëdhënieve të mira me veten, me të tjerët dhe me mjeshterin ku jetojmë.

CILAT JANË KRITERET E PRANIMIT?

Mosha mbi 18 vjeç

Diplomë e Maturës Shtetërore

Programet e studimit janë të përshtatshëm për të gjithë ata që kanë interes për fushën e estetikës, make up-it dhe parukerisë. Aplikantët duhet të kenë njohuri bazë në kozmetologji.

DOKUMENTACIONI QË DUHET DORËZUAR NË MOMENTIN E REGJISTRIMIT

Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës.

Fotokopje të noterizuar të diplomës së gjimnazit dhe certifikatës së notave.

Mandat pagesa e tarifës së shkollës.

SI MUND TË KONTAKTOJMË PËR MË SHUMË INFORMACIONE?

Facebook: TESS – Tirana Esthetics & Style School

Instagram: @tess.albania

Email: info@tess.al

Cel: +355694000014 / +355694000113 / +355694000115

Ruga "Gjeneral Nikols" Pallati Shushica, Katë i parë Tiranë, Shqipëri.

Zbulo më shumë

